



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 25, datë 27. 04. 2022

**“PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË BONUSIT TË QERASË SË BANESËS
FAMILJES SË SYRJA SHKËMBI, NGA FSHATI LIQETH, NJËSIA
ADMINISTRATIVE QËNDËR, BASHKIA SKRAPAR”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 27.04.2022, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 29, “Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike”, pika 1, Mbrojtjen civile në nivel vendor dhe administrimine strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Ligji Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 30, Bashkitë kanë këto detyra, gërma “f”, kryejnë investime parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese nga fatkeqësitë dhe informojnë për këto investime në mënyrë të vazhdueshme Prefektin e Qarkut, si dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Në zbatim të VKM- së Nr.329, datë 16.05.2012, kreu III, pika 3, Përcaktimi i ndihmës financiare, gërma “dh”, Kur studimi i kryer nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar rekomandon ndërtimin e banesës në një vend tjetër, akordimi i fondeve jepet me miratim të Lejes së Ndërtimit, sipas akteve ligjore në fuqi, si dhe vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.65 datë 24.12.2021 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe buxhetit të vitit 2022 për Bashkinë Skrapar dhe institucionet ne varësi të saj”, për parandalimin e ndonjë situatë të padëshirueshme me banesën e shtetasit Syrja Shkëmbi,

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit të qirasë së banesës në Çorovodë, për strehimin e familjes së Z.Syrja Shkëmbi nga fshati Liqeth, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Skrapar, për periudhën Prill - Dhjetor 2022.

Nr	Emër Mbiemër	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
1	Syrja Shkëmbi	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	45.000 Lekë
2	Totali	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	5000 Lekë	45.000 Lekë

2. Vlera prej 45.000 Lekë, do të përdoret nga Bashkia Skrapar, nga artikulli 602, zëri shpenzime operative administrata, në programin buxhetor administrim, planifikim, menaxhim.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Tatim Taksave
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 12 vota pro , votë kundër – s'ka, vota abstenim - s'ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI

